



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 397/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha, Kryesues, Zyhdi Haziri dhe Rafet Haxhaj anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarës së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesat e parashtruara nga Partia Liberale Egjiptiane (PLE), dega në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit për shpalljen e rezultateve përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 29.06.2017, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 02.07.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHEN** si të pabazuara ankesat Anr.397, Anr. 398 dhe Anr. 399 të parashtruara më datë 30.06.2017, nga Partia Liberale Egjiptiane (PLE), dega në Prishtinë.

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar tre ankesa me datë 30.06.2017 në ora 12:20, nga Partia Liberale Egjiptiane (PLE), dega në Prishtinë, në të cilat:

**Ankesa Anr.397/2017** - ankuesi pretendohet se me rastin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ), numëri i përgjithshëm i votave të tyre nuk janë evidentuar në formularin e përputhjes së rezultateve si dhe nuk është bërë bartja e rezultateve të dalura nga fletëvotimet në formularin e përputhjes së të dhënave dhe rezultateve nga ana e kryesuesve të vendvotimeve në disa komuna si: **në komunën e Prizrenit:** QV 2021A në VV 01R dhe 02D, **në komunën e Gjakovës:** QV 0203C VV04R, QV 0220C VV01D, QV 0214C VV 01R, 02R dhe 03R, QV 0232C VV 01R, QV0215CVV 01R dhe 02R, **në komunën e Pejës:** QV 1725C në VV 01R, 02R, 03R, 04R, 05R, dhe 06R, QV1725Cne VV01R, 02R 1723C VV0 1R,02R, 03R, 04R, 05R, 06R, 07R, QV 1713C VV 01R, 02R, 03R, 04R 05R, QV 1714C VV 01R, 02R, 03R, 04R, QV 1710C VV 01R, 02R, QV 1727C VV 01R, 02R, QV 1727C VV 01R dhe 02R, dhe **në komunën e Rahovecit:** QV 1610A VV01R, 02R, 03R.

**Ankesa Anr. 398/2017-** ankuesi pretendon se Partia Liberale Egjiptiane (PLE), në komunën e Deçanit ka pasur 34 vota ndërsa në rezultatin përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) figurojnë vetëm 17 vota.

**Ankesa Anr. 399/2017**, -ankuesi pretendon se Partia Liberale Egjiptiane (PLE), nga votuesit jashtë Kosovës kanë fituar 500 vota ndërsa në rezultatin përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) figurojnë vetëm 126 vota.

Në ankesat e parashtruara Partia Liberale Egjiptiane (PLE), ka kërkuar nga PZAP-i që të bëhet verifikimi i numërit të votave në qendrat e votimit të lartë cekura dhe votat e votuesve jashtë Kosovës.

Paneli i PZAP-it, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurat e PZAP-it, ka bashkuar ankesat e lartëcekura dhe i trajton si një ankesë të evidentuar me Anr 397/2017, për shkak të natyrës së njejtë të rasteve dhe pretendimeve, ankesën Anr 398/2017 dhe Anr 399/2017, vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë së ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

#### **ankesa është e pabazuar**

PZAP-i, konstatoi se parashtruesja e ankesave PLK, me ankesat e saj kërkon që të verifikohen kutitë e votimit në Komunën e Gjakovë, Prizreni, Pejë dhe Rahovec si dhe verifikimi i votave të votuesve jashtë Kosovës, sepse nga rezultatet përfundimtare të publikuara nga KQZ e njejtë numërin e përgjithshëm të votave të saj nuk janë evidentuar në formularin e përputhjes së rezultateve si dhe nuk është bërë bartja e rezultateve të dalura nga fletëvotimet në formularin e përputhjes së të dhënave dhe rezultateve, nga ana e kryesuesve të vendvotimeve

Paneli vlerëson se Ankuesi me asnjë provë bindëse nuk është dëshmuar pretendimet ankimore se në vendvotimet e lartcekura janë bërë parregullsi e pretenduara, prandaj lidhur me këtë çështje PZAP-i ankesat e parashtrueses i konsideron si të përgjithshme dhe të pabazuara për faktin se ankesa e parashtruar nuk i plotëson standardet ligjore si dhe kërkesat e nenit 117 të LZP-së 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përngjithme në Republikën e Kosovës.

Prandaj, PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase parashtruesja e ankesës nuk ka ofruar asnjë dëshmi për ti vërtetuar pretendimet ankimore lidhur me parregullsitë e pretendua. Parashtrimet në ankesë nuk paraqesin bazë ligjore për parregullsi dhe për rrjedhojë as referencë ligjore për marrjen e vendimit në favore për ankuesin.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në ankesa, konstaton se ankesat në fjalë janë të pabazuara dhe të pa argumentuara dhe si të tilla ankesat i refuzoi si të pabazuara.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa**

Anr.397/2017 më datën 02.07.2017.

**Kryesuesi i Panelit**  
**Ymer Hoxha**



***Udhëzim Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*